



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, **Zizë Bujupaj**, menaxhere e Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe

Horn & Co. Kosova Shpk, Komuna e Deçanit, të cilën e përfaqëson z. **Admir Hasanaj**, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810962739 perkatesisht, 810192998 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I LKËNEVE NË BJESHKËT E KALIQANIT – Lot 3

Nr. I prokurimit	633-20-5023 5-2-1/ C 376 LOT 3
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 079 / 521 – LOT 3

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I LKËNEVE NË BJESHKËT E KALIQANIT – Lot 3

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **NDËRTIMI I LKËNEVE NË BJESHKËT E KALIQANIT – Lot 3** është: **16.042,00 €** dhe me fjalë: /Gjashhtëmbëdhjetëmijëzerokatërdhjetedyzerozero €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 15.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për




pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"Horn & Co Kosova" Shpk

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Admir Hasanaj
Pozita:	U.D. Menaxher-it i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.10.2020	Data:	14.10.2020
Vu la		V u l a	

Numri i Prokurimit: 633/20/079/521– Titulli LOTO 1-MIREMBAJTJA E RRUGEVE MALORE, LOTO2-HAPJA E RRUGES MALORE STUDENICE-LUGU I MOHALLES, LOTO 3-RREGULLIMI I LEKENEVE PER UJI NE BJESHKET E KALIQANIT, LOTO 4-HAPJA E RRUGES MALORE POLANE-OSHLAK,dhe LOTO 5-HAPJA E RRUGES MALORE LUGU I MEHAJVE-STANET E LUBOVES

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë:GJUHA SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 30DITE ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite nga nënshkrimi i kontrates
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë:60 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25%</i> për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: ska
Zgjidhja miqësore e	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet

Numri i Prokurimit: 633/20/079/521– Titulli LOTO 1-MIREMBAJTJA E RRUGEVE MALORE, LOTO2-HAPJA E RRUGES MALORE STUDENICE-LUGU I MOHALLES, LOTO 3-RREGËLLIMI I LEKENEVE PER UJI NE BJESHKET E KALIQANIT, LOTO 4-HAPJA E RRUGES MALORE POLANE-OSHLAK,dhe LOTO 5-HAPJA E RRUGES MALORE LUGU I MEHAJVE-STANET E LUBOVES

mosmarrëveshjeve		ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

PARAMASA DHE PARALLOGARIA: NDËRTIMI I LKENEVE NË BJESHKËT E KALIQANIT

Në çmim duhet të parashlihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve të nevojshme para lëshuarës në punë. Sistemi i materialeve, pastrimi i punishtes nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes së punimeve.

A: PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE

I	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
1.1	Heqja e shkurreve, pastrimi i terrenit ndertimor (sipas nevojës)	paushall	4	60.00 €	240.00 €
1.2	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) me makinë në thellesi prej 110 cm për hapjen e lkeneve	m ³	1500	2.00 €	3,000.00 €
1.3	Furnizimi, shtrirja/mbushja dhe ngjeshja e zhavorrit (tampon nga guri i thyer me granulometri 0-16 dhe 032 mm), me trashësi t=15 cm në dy shtresa me ngjeshje të mirë.	m ³	340	11.00 €	3,740.00 €
1.4	Furnizimi, dhe vendosja e shtresës mbrojtëse të hidroizolimit - thasë të mbushur me zhavor rrethor sipas projektit.	m ³	175	15.00 €	2,625.00 €
Total poz. 1					9,605.00 €
2	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
2.1	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit (PVC i kualitetit të lartë me një shtresë) të lkeneve sipas projektit, në çmim të përfshihet edhe shtresa mbrojtëse e hidroizolimit - gjeotekstili.	m ²	1287.50	5	6,437.50 €
Total poz. 2					6,437.50 €

Verejtje: të gjitha pozicionet duhet të kryhen në lartësi mbidetare 1700 m në terene bjeshke dhe në largësi max 20 km nga qyteti i Istogut

REKAPITULIMI LKENET					
1	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				9,605.00 €
2	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				6,437.50 €
TOTALI I PUNEVE NDËRTIMORE DHE ZEJTARE ME TVSH:					16,042.50 €



Dega PEJË

Numri i polices 060030080074124

1 Të dhënat për agjentin - Agent details

Emri dhe mbiemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Beq Hadergjonaj	Deçan	044 180 180	003008

2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë

I SIGURUARI	Horn&Co Kosova sh.p.k.		
Adresa	Lëbushë-Deçan Deçan		
Përfaqësuar nga Z.	ADMIR HASANAJ	Nr. i biznesit	810962739

3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji:	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT
Titulli: Lot 3-Rregullimi i Lekeneve per uji ne Bjeshket e Kaliqanit Nr i Prokurimit:633-20-5023-5-2-1 Nr i Brendshem i prokurimit:633/20/079/521	

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfituesi	Komuna e Istogut
Adresa	Fadil Ferati, nr.121
Shuma e siguruar €	1,604.25 €

4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efekt i veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit lillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfituesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfituesi nuk mund të paraqes kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfituesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë Fillon me: 14.10.2020 Mbaron me: 12.01.2021

5

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
1,604.25 €	24.10 €	4.34 €	28.44 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht 28.44 € Date: 14.10.2020 Me këste: Numri i kësteve
Premium is paid completely in Installments:Nr. of Inst.

Shënime tjera:

I Siguruari / The Insured
ADMIR HASANAJ

Data e lëshimit / Issued date
14.10.2020

Siguruesi / The Insurer
Beq Hadergjonaj



(Handwritten signature of Admir Hasanaj)

(Handwritten signature of Beq Hadergjonaj)

SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Istogut**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **Horn&Co Kosova sh.p.k.**, Lëbushë-Deçan Deçan
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Titulli: Lot 3-Rregullimi i Lekeneve per uji ne Bjeshket e Kaliqanit
Nr i Prokurimit:633-20-5023-5-2-1
Nr i Brendshem i prokurimit:633/20/079/521

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitohet sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Nje mije e Gjasht qinde e Kater e Njzet e Pes 1,604.25 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmimeve të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,604.25 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **90 ditë prej 14.10.2020 deri më 12.01.2021**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Rr.Sylejman Vokshi, Pallati i Kuq, Hyrja B, nr.1, Prishtinë

